

VENDIM
Nr. 20, datë 31.1.2020

**MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE TË
PRODHUAR NGA BURIMET E VOGLA TË RINOVUESHME NGA DIELLI, ME
FUQI TË INSTALUAR DERI NË 2mw, PËR VITIN 2019**

Në mbështetje të nenit 10, pika 2 dhe 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 10, pika 3, të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 580, datë 28.8.2019, “Për miratimin e planit të konsoliduar kombëtar të veprimit për burimet e rinovueshme të energjisë, 2019–2020” dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 369, datë 26.4.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme, nga dielli dhe era”; nenit 15, të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 31.1.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 24/5 prot., datë 28.1.2020, si dhe relacionin shtesë nr. 24/5-1 prot., datë 30.1.2020, të Drejtorisë së Tarifave dhe Çmimeve,

konstatoi se:

- ERE ka detyrimin e përcaktimit të çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme, nga dielli dhe era, në bazë të nenit 10, pika 3, të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”.

- VKM-ja nr. 369, datë 26.4.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike, të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme, nga dielli dhe era”, në pikën 2 të tij, ngarkon ERE-n me detyrimin për miratimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike, të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme, nga dielli dhe era, në përputhje me çmimin e mesatarizuar për vitin 2019, sipas parashikimeve të kësaj metodologjie.

- Me vendimin nr. 193, datë 2.12.2019, ka vendosur fillimin e procedurës “Mbi përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike, të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme, nga dielli, me fuqi të instaluar deri në 2 mw, dhe era, me fuqi të instaluar deri 3 mw, për vitin 2019”.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje, ERE, me shkresën nr. 805, datë 10.12.2019, ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoritetin e Konkurrencës dhe palët e interesuara, lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e këtij akti, me qëllim shprehjen e komenteve apo opinioneve të tyre me shkrim brenda 15 ditëve nga marrja dijeni.

- Në përfundim të afatit të lartpërmendur, janë paraqitur komente vetëm nga shoqëria “Statkraft Renewables Albania” sh.p.k., e cila me shkresën nr. 805/1, datë 12.12.2019, është shprehur se: “Statkraft AS e konsideron këtë projekt si një investim strategjik dhe është në pritje të miratimit të çmimit nga Bordi i ERE-s, sa më shpejt të jetë e mundur”.

- Më herët, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, me shkresën nr. 9437 prot., datë 31.10.2019, protokolluar në ERE me nr. 690 prot., datë 1.11.2019, është shprehur: “sugjerojmë që për përcaktimin e çmimit të energjisë elektrike, të prodhuar nga burimet e vogla gjeneruese fotovoltaike lundruese, të merret në konsideratë metodologjia e vlerësimit të kostove të energjisë nga burime të rinovueshme, e cila mbështetet tek e njëjta formulë e LCOE-së, e njohur si kosto e nivelit mesatar të energjisë (LEC)”. Kjo vlerë e llogaritur është një vlerësim ekonomik i rendit të parë të kostonë së konkurrencës së një sistemi (në këtë rast PV tokë, notues, eolik) të energjisë elektrike gjeneruese, që përfshin të gjithë shpenzimet rreth kohëzgjatjes së jetës së saj”.

- VKM-ja nr. 369, datë 26.4.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike, të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era” ka përcaktuar kriteret e llogaritjes së çmimit, duke u bazuar në kthimin e arsyeshëm të vlerës së investimeve, sipas llojit të teknologjisë së përdorur. Në themel të metodologjisë së miratuar me VKM-në e lartpërmendur, është llogaritja e kostos së prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme nëpërmjet formulës llogaritëse të LCOE-së (kosto e niveluar e energjisë elektrike).

- Pika 2 e përfundimeve të metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme, nga dielli dhe era, miratuar me VKM-në nr. 369, datë 26.4.2017, përcakton se: Mbështetur në ligjin nr. 7/2017, neni 10, pika 3, Enti Rregullator i Energjisë do të miratojë çmimin e blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të , nga dielli dhe era, në përputhje me çmimin e mesatarizuar për vitin 2017, sipas parashikimeve të kësaj metodologjie, bazuar në referencat e tabelës së mësipërme (tabela e pikës 1 të përfundimeve të metodologjisë së miratuar me VKM-në nr. 369, datë 26.4.2017) për sa u takon LCOE-së dhe WACC-së ose të dhënave konkrete të kostove të investimeve që mund të sigurohen për vitet në vijim.

- Bazuar në dokumentacionin në dispozicion, gjatë vitit 2019 ka rezultuar vetëm shoqëria “Statkraft Renewables Albania” sh.p.k., si mbajtëse e miratimit përfundimtar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit fotovoltaiik lundrues mbi rezervuarin e Banjës, Bashkia Cërrik, me kapacitet të instaluar 2 mw.

- Shoqëria “Statkraft Renewables Albania” sh.p.k., me shkresën nr. 303 prot. hyrës, datë 17.4.2019, ka depozituar në ERE planin e biznesit për projektin Impianti Fotovoltaiik Lundrues 2 mw, mbi rezervuarin e Banjës, si dhe me shkresën nr. 805/2, datë 23.12.2019, ka paraqitur kontratën që ka lidhur me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për ndërtimin e këtij impianti.

- Për rrjedhojë, janë marrë në konsideratë të dhënat mbi komponentët përbërës, të nevojshëm për llogaritjen e LCOE-së, nga burimet si më poshtë vijon:

- kontrata e nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe shoqërisë “Statkraft Renewables Albania” sh.p.k. (vlera e investimit, orët e punës);

- VKM-ja nr. 369, datë 26.4.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme, nga dielli dhe era” (WACC);

- plani i biznesit të shoqërisë Statkraft, siç është paraqitur në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë në procedurën e marrjes së miratimit përfundimtar (shpenzimet operative, degradimi vjetor i prodhimit, jetëgjatësia e inverterit).

- Gjatë shqyrtimit në mbledhjen e Bordit, u bë prezent që, për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga impiantet fotovoltaike lundruese, me kapacitet të instaluar deri në 2 mw, janë marrë në konsideratë parashikimet e VKM-së nr. 369, datë 26.4.2017, VKM-së nr. 580, datë 28.8.2019, si dhe plani i biznesit për projektin Impianti Fotovoltaiik Lundrues 2 mw mbi rezervuarin e Banjës dhe kontrata që ka lidhur Subjekti me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për ndërtimin e këtij impianti.

- Në zbatim të sa më sipër dhe nisur nga eksperiencia e krijuar për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga impiantet prodhuese fotovoltaike në tokë me kapacitet të instaluar deri në 2 mw, gjatë periudhës paraardhëse, është llogaritur çmimi i blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga impiantet fotovoltaike lundruese, me kapacitet të instaluar deri në 2 mw, duke përdorur modelin e *excel*-it, të hartuar nga AGORA në studimin e saj për Shqipërinë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga impiantet fotovoltaike lundruese me kapacitet të instaluar deri në 2 mw prej 100.025 euro/mwh, për vitin 2019.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti